

## Mishi i Brazilit në tregun e Maqedonisë

## Tezgat e mbushura me mish dhe me rroba

ANILA LIMANI

**Shkup** - Mishi që vjen nga Brazili nëpërmjet rrugëve ilegale vazhdon të shitet në Maqedoni, në të shumtën e rasteve në kushte të papërshtatshme higjienike, nëpër tezgat e pazareve. Bashkë me mishin e kontrolluar, (që i plotëson kushtet) shpeshherë ka raste kur nga Brazili kanë mbërritur në Maqedoni edhe tonelata të mishit të pakontrolluar. Ky mish hyn në Maqedoni, nëpërmjet vendkalimeve kufitare, në sy të doganierëve, por ka edhe raste kur tregtia me këtë mish bëhet edhe nëpërmjet mallit, me kuaj të ngarkuar me mish. Më pas ky lloj mishi përfundon nëpër kuzhinat e restoranteve të ndryshme, si dhe në tezgat e tregjeve të gjelbërta, ku nuk ka asnjë lloj kushti higjieno sanitar. Në treg ky mish që hyn në mënyrë ilegale shitet me një çmim shumë më të ulët sesa mishi që shitet në mishore (dy të tretat e çmimit të mishit vendor). Kushtet e vështira ekonomike dhe sociale kanë bërë që qytetarët ta blejnë këtë mish, edhe pse, edhe tek ata ekzistojnë dyshime për pasojat që mund ti kenë prej konsumimit të tij. Shitësit nëpër tezga thonë se nuk përfitojnë asgjë më tepër sesa një kafshatë buke për fëmijët e tyre. Fitimi më i madh shkon te pronarët e mishit të cilët e marrin atë me shumicë dhe e ruajnë nëpër magazina në periferi të Shkupit. Ekspertët sqarojnë se vetëm gjatë tre orëve të ekspozimit të mishit në kushte të papërshtatshme zhvillohen 5 milionë baktere, të cilat edhe pse nuk janë patogjene për njeriun, kur janë në numër të madh bëhen të rrezikshme për të. Po të kalosh nëpër tezgat e Bit Pazarit në Shkup do të vëshesh se një rresht i tërë është i mbushur me prodhime mishi, ku më së

shumti mbizotëron mishi i Brazilit.

**Mishi shitet në të njëjtën tezgë me rrobat**

Autori këtij teksti fotografoi një pamje që i bën përshtypje të gjithëve, përveç inspektorëve, të cilët ose nuk shohin, ose nuk duan të shohin. Në të njëjtën tezgë në tregun e bit pazarit



► Rroba dhe mish në një vend

shitet rroba nga njëra anë dhe mish Brazili, i sjellë në mënyrë ilegale në Maqedoni nga ana tjetër. Ky mish që shitej në këtë tezgë nuk përmbante asnjë etiketë apo shenjë që të tregojë për prejardhjen e tij. Shitësi nuk pranon të flasë, por vetëm thërret ejani blini mish me të lirë, është i freskët, thërret ai. Kur afroresh pranë sheh vërtetë çmim të lirë të mishit nga 170 deri në 260 denarë për kilogram, varësisht prej llojit, por freski nuk sheh askund, pasi ai është mish i ngrirë Brazili, i cili ka filluar të shkrijë për shkak të ekspozimit në diell. Teksa ecën nëpër treg dhe e pyet shitësin e parë se çfarë mishi është, ai do të përgjigjet: Mish Brazili, të gjithë

mish Brazili shesin, dije se nëse e thonë të kundërtën gënjejnë. Dhe teksa vëren tezgat me mish sheh se në ndonjërin prej tyre mishi ka etiketa, ndërsa në shumicën e tyre asgjë të shkruar. Etiketat janë shenjë që të siguron se ai mish nuk ka hyrë në mënyrë ilegale në Maqedoni. Por, edhe ai që ka etiketa nuk është e sigurt nëse ka hyrë në

rrugë të ligjshme apo të paligjshme, se etiketa me vula fallso bëhen në çdo skaj të Shkupit. Një shitës në tregun e gjelbër thotë se etiketat e mallit i ndërrojnë shpesh. "Sa herë që mallit i kalon data e , i vëmë etiketa të reja me data të reja", thotë ai.

**Malli blihet në magazina në periferi të qytetit**

Një shitës që shet mish Brazili dhe prodhime të tjera mishi në tregun e bit Pazarit thotë se ka 6 vjet që shet mish Brazili në pazar. "Punoj këtu për çdo ditë, dimër e verë. Duhet të punoj, kam fëmijë që duhet të rriten e shkollohen", nis bisedën ai. Thotë se nuk ka shumë fitim, pasi mishin e blen

shtrenjtë tek persona që shesin mish me shumicë, të cilët e ruajnë nëpër magazina në periferi të Shkupit. "Unë nuk fitoj as nga 40 denarë për kilogram. Mishin e marr me 180 denarë dhe e shes me 220 denarë. Edhe nga mishi i bluar i Brazilit, ose nga mëlçitë nuk kam ndonjë fitim të madh", thotë ai, duke shtuar se edhe njerëzit tashmë nuk kanë para për të blerë. "Blejnë, por kohëve të fundit ka rënë shumë puna. Njerëzit s'kanë para me ble mish. Më tepër blejnë për festa, ose kur kanë ndonjë gëzim familjar. Krizë është gjithandej", thotë ai, duke kujtuar kohën e 4-5 viteve më parë, kur dhe biznesi i tij ka qenë në "lulëzim". "Përpara kishte punë, blinin njerëzit", thotë ai, duke sqaruar mënyrën se si furnizohet me këtë prodhim. "Nuk e di në e sjellin në rrugë të ligjshme apo të paligjshme, unë shkoj marr mall dhe jam marrë vesh që paratë tua jap pasi ta shes atë. Kjo më konvenon mua ndaj dhe për vite me radhë marr mall tek i njëjti person", thotë ai. Ndërkaq, qytetarët edhe pse dyshojnë tek ky lloj mishi, sërish e blejnë atë për shkak të çmimit më të lirë. Një qytetar që bleu mish Brazili në Pazar thotë se e ka zgjedh këtë lloj mishi se është më i lirë. Ai nuk mendon shumë nëse mishi është i kontrolluar apo jo, për të me rëndësi është çmimi, ndërsa për shijen ai është i vetëdijshëm, por thotë: Kaq ma mban xhepi. "Ndoshta ka hy në mënyrë ilegale, po ato punë nuk më interesojnë mua, le ti zgjidh shteti ato. Ç'më duhen mua ato punë", thotë ai, duke ikur me nxitim. (vazhdon)

*Kjo storje është realizuar me mbështetjen e SCOOP dhe Shoqatës Daneze për Gazetari Huluntuuese*